



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Komiteti për Politikë dhe Financa

Nr. 02-060/01-0033605-1/24 dt. 28.05.2024

Mitrovicë

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa

Mbledhja e 29

Koha: 28.05.2024 ora 10:00

Vendi: Salla e Mediave

Të pranishëm: Kryesuesja e Kuvendit znj. Vesa Broja

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa: Fadil Veseli, Nazmije Sejdiu, Vesel Neziri, Shkurta Shosholli Musa, Hysen Muzliukaj, Erseka Barani, Muhamed Hoti dhe Xhyljeta Imeri

Drejtorët e Drejtorive

Mungoi:

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi Kryesuesja e Kuvendit znj. Vesa Broja e cila theksoi se në zbatim të nenit 52, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisjen lokale; nenit 11 paragrafët: 1, 2 edhe 5 të Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr. 05/2020 Për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në komunë; nenit 62, të Statutit të Komunës së Mitrovicës; nenit 15, pika 2, të Rregullores Komunale për punën e komiteteve të Kuvendit të Komunës, për sot ka thirrur mbledhjen e njëzetentë të Komitetit për Politikë dhe Financa, me rendin e ditës të paraparë me thirrje.

Kryesuesja në vazhdim theksoi se me e-mail keni marrë Qarkoren Buxhetore 2025/01 për Komunën e Mitrovicës e cila propozohet të hyjë në rend dite si pikë e 6-të.

Në vazhdim Kryesuesja hapi diskutimin lidhur me rendin e ditës.

Pasi nuk kishte të lajmëruar për diskutim, Kryesuesja vuri në votim propozimin që pikë e 6-të e rendit të ditës të jetë: Qarkorja Buxhetore 2025/01 për Komunën e Mitrovicës.

Komiteti për Politikë dhe Financa miratoi unanimisht (9 për, 0 kundër dhe 0 abstenime) propozimin që pikë e 6-të e rendit të ditës të jetë: Qarkorja Buxhetore 2025/01 për Komunën e Mitrovicës.

Në vazhdim Kryesuesja vuri në votim këtë rend dite:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

2. Propozim për ndarjen e titullit “Qytetar Nderi” për z. Bernd Baumgarten
3. Propozim-vendim për caktimin e qirasë për shfrytëzuesit e Parkut Industrial dhe Parkut Teknologjik në Mitrovicë
4. Raport i Komisionit Komunal të Aksionarëve të NPL “Stacioni i Autobusëve” sh.a. për vitin 2023
5. Raport i Komisionit Komunal të Aksionarëve të NP “Tregu” për vitin 2023
6. Qarkorja Buxhetore 2025/01 për Komunën e Mitrovicës

Rendi i ditës u miratua unanimitisht.

Pika 1

Procesverbali nga mbledhja e kaluar u miratua unanimitisht.

Pika 2

Kryesuesja znj. Vesa Broja para se të hapë diskutimin lidhur me Propozimin për ndarjen e titullit “Qytetar Nderi” për z. Bernd Baumgarten, në mungesë të Kryetarit të Komunës, për ta arsyetuar të njëjtën fjalën ia kaloi Drejtorit të DIEZHET z. Elvis Feka.

Pas arsyetimit të pikës nga Drejtori i DIEZHET z. Elvis Feka, Kryesuesja e mbledhjes hapi diskutimin.

Hysen Muzliukaj: Propozimit për ndarjen e titullit “Qytetar Nderi” për z. Bernd Baumgarten, i mungon CV-ja dhe i tërë dokumentacioni tjetër i nevojshëm i veprimtarisë së tij, po dalim jo serioz me këto propozime, nuk është hera e parë që e bëjë këtë vërejtje, për seancën e Kuvendit ky propozim të na vije i kompletuar me tërë dokumentacionin e nevojshëm.

Pasi nuk kishte të lajmëruar tjerë për diskutim, Kryesuesja vuri në votim Propozimin për ndarjen e titullit “Qytetar Nderi” për z. Bernd Baumgarten, me propozimin që për mbledhjen e Kuvendit propozimit t’i bashkëngjitet një CV dhe dokumentacioni tjetër i nevojshëm i veprimtarisë së personalitetit të propozuar.

Propozimi për ndarjen e titullit “Qytetar Nderi” për z. Bernd Baumgarten u miratua unanimitisht (9-për, 0-kundër dhe 0-abstenime) dhe i njëjti i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Pika 3

Kryesuesja para se të hapë diskutimin lidhur me Propozim-vendimin për caktimin e qirasë për shfrytëzuesit e Parkut Industrial dhe Parkut Teknologjik në Mitrovicë për ta arsyetuar të njëjtën fjalën ia kaloi Drejtorit të DIEZHET z. Elvis Feka.

Elvis Feka: Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës dhënia e 14 parcelave në Zonën Ekonomike në Mitrovicë, dhe pas procedimit të të njëjtave në Zyrën Ligjore, Zyra Ligjore me hyrjen në fuqi të Ligjit të ri për parqet industriale dhe teknologjike ka kërkuar që për Parkun Industrial dhe Parkun Teknologjik në Mitrovicë të vendoset një tarifë me qëllim të mbulimit të kostos për funksionimin e zonës, me qëllim të gjenerimit të të hyrave dhe menaxhimit sa më të mirë të parkut, e pastaj të vazhdohet me nënshkrimin e kontratave. Si pasojë e kësaj ne kemi pasur takim edhe me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, ministri përgjegjëse për parqet industriale dhe gjatë analizimit së bashku

me ta dhe praktikës se si veprojnë edhe me parqet tjera në Kosovë, bazuar në programet për menaxhimin e zonave ekonomike është cekur një tarifë e cila ka qenë e cekur 0.03 € për m² në 3 vitet e para, pastaj 0.15 m² në vitet vijuese, kjo është për parkun në Drenas ndërsa në disa komuna tjera është 0.05 € për m² për komplet pjesën e shfrytëzimit. Bazuar në këto ne kemi ardhur në përfundim që tarifa të jetë 0.05 € për m² dhe të vazhdohet tutje me nënshkrimin e kontratave.

Fadil Veseli: Si taksë dhe tarifë e ka arsyen e vet, më intereson të di taksa prej 0.05 € për m² a është për objekt a për pronë, kjo të definohet. Po ashtu kam një sugjerim, lidhur me parkun e bizneseve të merret si model parku i bizneseve në Drenas, kanë pasur shumë vështirësi deri sa kanë arritur këtu ku janë, por ia kanë dalë.

Hysen Muzliukaj: Procedurat për 14 pronat të cilat i ceku drejtori janë zhvilluar pa e ditur që ka me pasur qira, tani kemi ardhur te një momentum, pasi janë shpallur përfituesit para se me u nënshkruar kontratat, në muajin nëntor ka hyrë në fuqi Ligji i ri për parqet industriale dhe teknologjike, ky detaj iu ka ikur dhe kjo nuk është mirë. Me ligjin e vjetër këta përfitues e kanë fituar të drejtën e shfrytëzimit, dhe për ato prona nuk mundni me qitë qira, nuk ka vendim retroaktiv, në çdo gjykatë këta përfitues do ta fitojnë rastin sepse ligji e thotë gjithmonë në favor të palës, janë zhvilluar procedurat me ligjin e vjetër ata nuk do të paguajnë qira, sepse askund në konkurs nuk ka qenë e cekur qiraja, dhe nëse këtyre përfituesve u kërkohet qiraja është jo ligjore.

Kryesuesja e Kuvendit: Kam qenë pjesë e Komisionit, konkursi është hapur dhe ka përfunduar me ligjin e vjetër, ditën që u shpallë lista përfituese ka hyrë në fuqi ligji i ri, lista është shpallur paradite, ligji i ri ka hyrë në fuqi pasdite. Ne si Komision kemi vazhduar me ligjin e vjetër me të cilin edhe është hapur konkursi, i kemi vazhduar procedurat dhe është mbyllur konkursi, dhe rekomandimin të Kryetari e kemi dorëzuar me ligjin me të cilin janë zhvilluar të gjitha procedurat. Ne si Komision i kemi kryer të gjitha procedurat e nevojshme deri në miratimin në Kuvend, çështja që ka dalë është se Zyra Ligjore nuk i ka përgatitur kontratat me arsyetimin se ka hyrë në fuqi ligji i ri, se qysh procedon tutje Zyra Ligjore ne nuk e dimë.

Hysen Muzliukaj: Është absurde këtë që e ka thënë zyra ligjore, ata janë gabim, pyetni të gjithë juristët që i njihni, nuk ka qira për ata përfitues, procedurat janë zhvilluar me ligjin e vjetër dhe ajo e drejtë iu takon.

Kryesuesja Vesa Broja: Nuk ka nevojë që të përzihet çështja e 14 përfituesve me ligjin e vjetër me propozimin që ne sot e kemi në rend dite, propozimi është për përfituesit në atë zonë që do të jenë tash e tutje.

Elvis Feka: Sa i përket çështjes që e shtroi z. Veseli fjala është për m² për pronë.

Vesel Neziri: Mjerim për këto propozime që na i sjellë zyra ligjore, si KPF të dalim me rekomandim që qiraja të jetë për përfituesit e rinj, ndërsa për 14 përfituesit me ligjin e vjetër nuk duhet të diskutohet tarifa.

Pasi nuk kishte të lajmëruar tjerë për diskutim Kryesuesja vuri në votim Propozim-vendimin për caktimin e qirasë për shfrytëzuesit (tash e tutje) të Parkut Industrial dhe Parkut Teknologjik në Mitrovicë.

Propozim-vendimi për caktimin e qirasë për shfrytëzuesit e Parkut Industrial dhe Parkut Teknologjik në Mitrovicë u miratua unanimit (7-për, 0-kundër dhe 0-abstenime) dhe i njëjti i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Pika 4

Kryesuesja e mbledhjes hapi diskutimin lidhur me Raportin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të NPL “Stacioni i Autobusëve” sh.a. për vitin 2023.

Hysen Muzliukaj: Propozoj që për mbledhjen e Kuvendit, Raportit të Komisionit Komunal të Aksionarëve të NPL “Stacioni i Autobusëve” sh.a. për vitin 2023 t’i bashkëngjiten edhe kontratat e qirasë me operatorët ekonomik, me qëllim që të dimë se sa janë të hyrat vjetore nga qiraja për secilin operatorë.

Fadil Veseli: Te raporti është përvjedhur një gabim teknik, në faqe 2 shkruan viti 2022 ndërsa raportohet për vitin 2023, kjo të përmirësohet. Ndërsa sa i përket Raportit të Komisionit Komunal të Aksionarëve të NPL “Stacioni i Autobusëve” sh.a. për vitin 2023, raport më të mirë nuk ka pasur qe 12 vite. Sugjeroj që të konsultohet ndonjë ekspert dhe kioskat e vendosura aty të vendosen të gjitha në një zonë, do të ishte më mirë.

Pasi nuk kishte të lajmëruar tjerë për diskutim Kryesuesja vuri në votim Raportin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të NPL “Stacioni i Autobusëve” sh.a. për vitin 2023.

Raporti i Komisionit Komunal të Aksionarëve të NPL “Stacioni i Autobusëve” sh.a. për vitin 2023 u miratua unanimitisht (7-për, 0-kundër dhe 0-abstenime) dhe i njëjti i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim.

Pika 5

Kryesuesja e mbledhjes hapi diskutimin lidhur me Raportin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të NP “Tregu” për vitin 2023.

Pasi nuk kishte të lajmëruar për diskutim Kryesuesja vuri në votim Raportin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të NP “Tregu” për vitin 2023.

Raporti i Komisionit Komunal të Aksionarëve të NP “Tregu” për vitin 2023 u miratua unanimitisht (7-për, 0-kundër dhe 0-abstenime) dhe i njëjti i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim.

Pika 6

Kryesuesja e mbledhjes hapi diskutimin lidhur me Qarkoren Buxhetore 2025/01 për Komunën e Mitrovicës.

Pasi nuk kishte të lajmëruar për diskutim Kryesuesja vuri në votim Qarkoren Buxhetore 2025/01 për Komunën e Mitrovicës.

Qarkorja Buxhetore 2025/01 për Komunën e Mitrovicës u miratua unanimitisht (7-për, 0-kundër dhe 0-abstenime) dhe e njëjta i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Mbledhja përfundoi punimet në ora 11:00 min.

Mitrovicë

Procesmbajtës:


Merita PRETENI

Kryesuesja e Kuvendit


Vesa BROJA

